



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 SHKURT 2016, në orën 19:00

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. FEBRUARA 2016. GODINE, u 19:00 sati

SHKURT - FEBRUAR
2016

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-042 o javnim nabavkama Republike Kosova, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L237 i Zakonom br. 05/L-068

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë,

Jemi në seancën e re. Edhe nëpërmjet mediave, edhe nëpërmjet Administratës janë ftuar të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të procedurave të rregullta. Ta kemi këtë parasysh.

Të nderuar deputetë

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës së sotme plenare sipas rendit të ditës të caktuar me vendim të Kuvendit nga seanca plenare, e mbajtur sot, më 19 shkurt 2016.

Fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068 dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni ka arritur që për një afat të shkurtër të bëjë amendamentimin e draftit, të cilin e ka proceduar Qeveria lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik, respektivisht për emërimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Meqenëse ne e kemi amendamentuar, e kemi parë të arsyeshme që të bëjmë edhe një ndryshim sa i përket ekonomizimit të aktivitetëve të prokurimit për shkak të mungesës së kapaciteteve të Kuvendit lidhur me procedimin e prokurimit të agjencive të pavarura që kanë më pak se 50 punëtorë dhe këtë procedim të prokurimit ia kemi bartur Agjencisë Qendrore të Prokurimit.

Me këtë ne e kemi shkarkuar Kuvendin, por e kemi ngarkuar Agjencinë Qendrore të Prokurimit, për të cilën besoj se Qeveria duhet të ketë parasysh dhe t'i rrisë kapacitetet e kësaj agjencie.

Sa i përket çështjes kryesore që ka të bëjë me ndryshimin e Ligjit në fjalë, është emërimi i kryetarit dhe anëtarëve të OSHP-së. Kemi arritur që të bëjmë një precizitet të afateve kohore dhe Qeveria në një afat prej 90 ditësh të bëjë propozimin e së paku 2 anëtarëve për një vend të lirë në OSHP dhe mendoj që me këtë kemi arritur ta ruajmë konkurrencën që organi, i cili pastaj

zgjidhet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me kërkesën e Kuvendit, të bëjë përzgjedhjen e atyre që kanë vlerësime apo merita më të mira duke e bërë intervistimin dhe rangimin e tyre sipas poenëve.

Pastaj, e kemi rregulluar mirë edhe çështjen se cilat kritere duhet plotësuar për t'u proceduar dhe bërë anëtar ose kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe kemi saktësuar suspendimin, largimin dhe shkarkimin e kryetarit dhe të anëtarëve të OSHP-së dhe mendoj që këtë çështje e kemi rregulluar mirë, sepse ata që mund të kenë ndonjë vendim në formën e prerë nga organi gjyqësor, këtë suspendim ia kemi lënë vetë ligjit, ndërsa për çështjet tjera e ka të drejtën Qeveria t'i kërkojë Kuvendit dorëheqjen, apo ndërrimin e anëtarit në fjalë.

Me këtë, konsideroj se Kuvendi e ka përmbushur detyrimin apo kushtin që na është paraqitur lidhur me këtë ligj për plotësimin e njëres nga 8 pikat dhe unë u bëj thirrje të gjithë deputetëve që këto tri amendamente t'i votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit kryetar i Komisionit!

Jemi 72 deputetë të pranishëm në sallë. Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej tri amendamente. Ne do të shkojmë në votimin e amendamenteve të propozuar sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funkcional.

Numri i pranishëm të deputetëve është 72.

Votimin e amendamenteve do ta bëjmë veç e veç.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër?

Urdhëro! Fjalën e ka zonja Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Mendoj që personave të cilët akuzohen për vepra penale, nuk duhet t'u krijohen këto lloj privilegjesh, sa madje të paguhen me gjysmë page, e tjera, e tjera. Kjo jo vetëm në nivelin e këtij ligji të prokurimit, por për të gjitha ligjet, përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe institucionet.

Pra, unë nuk jam dakord që personat që janë nën aktakuzë të trajtohen në këtë mënyrë, madje edhe me paga. Në fakt, ata duhet të suspendohen, ta lënë detyrën, dhe t'u nënshtrohen hetimeve dhe proceseve gjyqësore. Kur ta fitojnë pafajësinë, pastaj mund të kthehen në vendin e punës, nëse e fitojnë, kështu që unë jam kundër kësaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj dhe zoti Çelaj e kanë kërkuar fjalën! Urdhëro zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne pikërisht në Komisionin për Legjislacionin kemi shqyrtuar dhe debatuar procedurat e largimit dhe shkarkimit, që kanë të bëjnë edhe me çështjen që lidhet nëse dikush bie ndesh me ligjin, por duhet ta kuptojmë - ata që janë juristë e dinë më mirë, është pezullimi i pafajësisë për një person i cili nuk mund të jetë i fajshëm derisa të kemi vendim të gjyqësorit, apo vendim të gjykatës të formës së prerë.

Andaj, kështu si është e paraqitur, është shumë në rregull, e kjo i takon edhe etikës profesionale, por edhe institucionit në të cilin dikush mund të ketë shkelje ligjore. Sido që të jetë, në këtë formë është rregulluar mirë dhe duhet kështu të procedohet.

KRYETARI: Urdhëro, zonja Alma e kërkon fjalën!

ALMA LAMA: Sa për sqarim zotit Zemaj! Natyrisht që e dimë se ç'është prezumimi i pafajësisë. Natyrisht se Kushtetuta e garanton një gjë të tillë, mirëpo duke u nisur nga praktikat, nga ajo që po ndodh në Kosovë, ne në fakt kemi nevojë për dekriminalizim, kështu që meqë jemi te ky ligj, unë jam kundër, por mendoj se duhen edhe disa ligje të tjera që t'u paraprijnë këtyre problemeve që janë shfaqur. Për shembull, kemi shumë e shumë, ta zëmë, zyrtarë, përfshirë edhe kryetarë komunash ose ish-kryetar, ose kryetarë aktualë të partisë tuaj, zoti kryetar, të cilët po përfitojnë nga ky ligj dhe nuk po u nënshtrohen proceseve, të cilave do të duhej t'u nënshtroheshin. Ta zëmë, ata që janë nën hetime, madje edhe janë shpallur fajtorë, do të duhej që t'i lëshonin pozitat dhe institucionet që i drejtojnë të funksionojnë në mënyrë demokratike. Të shkojnë në zgjidhje dhe të zgjidhen njerëz të tjerë.

Prandaj, e kisha fjalën vetëm për procesin e dekriminalizimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj prapë e ka kërkuar fjalën dhe në të njëjtën edhe zonja Tërmkolli. Urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Unë pajtohem plotësisht me pjesën e fundit që e tha zonja Alma Lama, sepse ndoshta është imediate thirrja që të gjitha institucionet në të gjitha nivelet të lirohen, apo të pastrohen nga njerëzit që janë të korruptuar, apo që kanë rënë ndesh me ligjin, pa marrë parasysh në cilin nivel. Por, unë prapë po theksoj në aspektin profesional, të gjitha ligjet që miratohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës, bazën dhe burimin e kanë në Kushtetutë, e cila tregon barazinë para ligjit. Do të thotë, për këtë po them se edhe ky ligj është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe vetë neni në fjalë.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Tërmkolli e ka fjalën!

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit! Këto fakultete dikush i ka kryer më herët, dikush pak më vonë, por nuk e di këtu profesionalizmi sa është në nivel dhe sa nuk është dhe me çka po e matim këtë. Sinqerisht, tash nuk është kjo çështje e Nënës Terezë për ta falur apo jo dikë. Kjo

është çështje ligjore, kushtetuese, dhe nuk kemi asnjë arsye që personi që ka mundur ta vrasë dikë, t'ia japësh pagën 50%, shembull.

Njeriu që suspendohet për vepër penale, suspendohet. E vërtetë është parimi i prezumimit të pafajësisë, mirëpo nëse shpallet i pafajshëm ose e pafajshme, atëherë janë mekanizmat tjerë, mënyrat dhe metodat për ta kompensuar këtë çështje. Në qoftë se ne në ligj këtë nuk mund ta pranojmë, kjo nuk është mirë.

KRYETARI: Do të shkojmë në debat të pafund! Zoti Zemaj prapë e kërkon fjalën! Zotëri Çela prapë! Atëherë, zoti Zemaj urdhëroni edhe një herë!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Tash u hap kjo temë shumë interesante, edhe për profesionalizmin dhe për çështjet që lidhen me sistemin e drejtësisë. Për vepra penale, që janë të dënueshme mbi 5 vjet, do të thotë njeriu shkon automatikisht në burg dhe s'ka nevojë as të marrë pagë, por shkon e vuan dënimin dhe është i zënë në vepër.

E sa u përket shkollimeve, është mirë që dikush e kryen shkollimin në kohën moderne, dikush pak më të vjetër dhe avancojnë kohët dhe rrethanat.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Raif Çela e ka fjalën!

RAIF ÇELA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në paragrafin 4 të nenit 101, do të thotë në amendamentin 3, pjesa e parë është e panevojshme. "Përveç siç është paraparë në paragrafin 2 të këtij neni"... Në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë vetëm suspendimi i anëtarit të OSHP-së, në rast se është ngritur aktakuzë ndaj tij.

Kjo i bie se kjo fjali është e tepërt këtu, sepse është për një çështje tjetër. Është kur Qeveria i propozon Kuvendit shkarkimin e kryetarit, apo të anëtarit të OSHP-së.

Prandaj kjo fjali, përveç siç është paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, këtu nuk e ka vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përveç zotit Gashi që e ka kërkuar fjalën, s'ka të tjerë të paraqitur, dhe do të shkojmë në votim. Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Debati që po bëhet këtu besoj është konceptual, por është e vërtetë ajo që e tha zoti Demaj - prezumimi i pafajësisë, se çdo kush prezumohet i pafajshëm derisa me vendim të formës së prerë të gjykatës vërtetohet fajësia e tij dhe po ashtu është e vërtetë edhe ngritja e aktakuzës mbi dyshimin e bazuar. Domethënë, Prokuroria e ngre aktakuzën mbi dyshimin e bazuar dhe në mes të dy këtyre përplasjeve konceptuale, mendoj se e kanë zgjedhur një zgjidhje të përshtatshme Komisioni, bashkërisht edhe me palët që janë konsultuar, edhe me Qeverinë, dhe zgjidhja është e përshtatshme, përveç nëse me ligj të veçantë mund të kërkohej. Në raste të veçanta, kemi pasur edhe këtu, në këtë Kuvend, kur kemi nxjerrë ligje që personat specifikë, për raste konkrete, në momentin që janë akuzuar janë trajtuar si persona që e kanë kryer veprën penale dhe pastaj, nëse kanë dalë të pafajshëm, e kanë vuajtur dhe s'kemi pasur çfarë të bëjmë.

Kështu, mendoj që Kuvendi po tregohet i kujdesshëm për këta persona që potencialisht do të mund të kryejnë, krime ose vepra penale, dhe gjasat janë shumë të mëdha, sepse tundimi është shumë i madh. Edhe kërkesat, edhe mjetet financiare që janë në qarkullim në këtë institucion janë shumë të mëdha, por mendoj se është dakorduar edhe me Zyrën e Bashkimit Evropian dhe me institucionet tjera, dhe mënyra se si është draftuar është e pranueshme, derisa të vijmë në një moment tjetër kur ky ligj në tërësi duhet të harmonizohet, sepse shumë herë është prekur në të dhe tashmë është çorientuar goxha shumë si ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë kemi të lajmëruar edhe dy deputetë. Zoti Beqaj e ka fjalën, le të përgatitet edhe një herë zonja Tërmkollli.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Unë u kyça pak me vonesë, për ta dhënë ndoshta një kontribut. Unë mendoj se neni 101, pika 1 bie në konfuzion me shumë nene tjera te personat apo te zyrtarët tjerë shtetërorë, për të cilët me ligjet tjera nuk rregullohet kjo çështje.

Për shembull, aktakuza mund të ngrihet nga Prokuroria dhe nga hetuesia kundër një personi, apo kundër ndonjë zyrtari të lartë të shtetit, por deri në vendim të gjykatës unë mendoj se nuk duhet të suspendohet, apo të largohet.

Arsyeja pse e them këtë mund të shkojë, për shembull, ne po themi që pritja kompensohet 50%, por ndoshta gjykata mund të shkojë 3 vjet ose 5 vjet në procedura të hetuesisë, e atëherë cili është kuptimi që t'i kthehet mandati, që mund t'i ketë kaluar. Ndoshta është dashur të formulohet ndryshe.

Shumë ligje tjera rregullojnë, nëse dënohet mbi 6 muaj burg, apo nëse e ka shkelur detyrën e punës, kuptohet nëse aty ka aktgjykim të prerë të gjykatës, kurse vetëm për aktakuzë, duke pasur parasysh edhe sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës, ndoshta mund të jetë nën presion, në këtë rast ky organ nën presion të operatorëve apo në presion të palëve të interesit, sepse ne e dimë që shpesh në Republikën e Kosovës ndodhin aktakuza, ndodhin shumë arrestime, por në fund kemi vendime të pafajësisë.

Nuk isha i kyçur më herët në këtë çështje, por po them se ky është mendim i imi, që derisa nuk do të ketë vendim të gjykatës, nuk mendoj se duhet të jetë i suspenduar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Tërmkollli e ka fjalën, e pastaj kryetari i Komisionit, zoti Osmani edhe një herë.

MELIHATE TËRMKOLLI: Kryetar, shumë shkurtimisht, vetëm një fjalë!

Nëse po dëshironi që ndonjë personi specifik t'ia përshtatni këtë nen - OK, krejt në rregull! Mirëpo ne e dimë shumë mirë se ka vite që kryetari i OSHP-së, ose kryesuesi, quajeni si të doni, me vite e vite ka aktakuzë dhe kurr gjë s'është ndërmarrë kundër tij, as kurr gjë s'është bërë.

Pra, nëse po dëshironi të shkoni kështu, OK - shkoni! Përndryshe, çështja e pagës rregullohet edhe me ligje tjera, edhe me rregulla tjera. E tash, nëse dëshironi të hidhni krënde, hidhni!

KRYETARI: Zoti Osmani, kryetar i Komisionit, e ka fjalën dhe pastaj shkojmë drejt votimit në këtë amendament. Mund të mos kalojë, është situatë e re.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Secili mund të bëjë vërejtje në mënyrën e vet, nga këndi i tij, por kjo është një çështje që ne e kemi vënë këtu përpara në konsultim me ata të cilët kanë kërkuar të bëhet ndryshimi dhe ky ndryshim është bërë për çështje të liberalizimit për këtë kohë dhe konsideroj se kjo është e mjaftueshme të kalojë.

Unë vetëm dua të kërkoj nga ju, zoti kryetar, që propozimi i Raif Çelës të merret në konsiderim se e kemi bërë një lëshim, një gabim teknik te neni 101, paragrafi 4, ku është numri 2 duhet të jetë 3. “Përveç siç është paraparë në paragrafin 2...”, siç është, duhet bërë “Përveç siç është paraparë në paragrafin 3”. Pra, jo 2, por 3. Pra, duhet përmirësuar këtë gabim teknik dhe duhet votuar në tërësi.

Dhe koleges sime Melihate, ky ndryshim dhe ky ligj nuk i bëhet asnjë personi dhe konsiderojmë që njerëzit të cilët do të shkojnë në atë institucion do të jenë ashtu siç i parasheh ligji.

KRYETARI: Faleminderit! Po përgatitemi për votim me këtë intervenim, pasi është bërë një gabim teknik. Pra, kemi të bëjmë me amendamentin 3 - pika 3: “Përveç siç është paraparë në paragrafin 3 të këtij neni”.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tash e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Do të votojmë në mënyrë elektronike!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë 71 deputetë.

Për kanë votuar 61!

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-068.

Me këtë i mbyll punimet e seancës së sotme plenare. Mirupafshim në vazhdimin e seancës, të mërkurën e ardhshme, në orën 14:00. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*